



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 12

Tiranë – E mërkurë, 22 janar 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 1, datë 15.1.2025	Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2025..... 807
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 24, datë 16.1.2025	Për delegim kompetence..... 807
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 35, datë 14.1.2025	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 807
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 42, datë 20.1.2025	Për delegim kompetence..... 808
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 280, datë 16.12.2024	Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a. për vitin 2025”..... 808
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 296, datë 30.12.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 mw..... 809
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 297, datë 30.12.2024	Mbi shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023..... 811
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 300, datë 30.12.2024	Mbi miratimin e rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme 813
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 301, datë 30.12.2024	Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin për periudhën 1.10.2023–30.9.2024..... 823

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 8.1.2025	Mbi përcaktimin çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e Shërbimit Universal të Furnizimit për periudhën 1 shkurt 2025–31 dhjetor 2025.....	825
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 11, datë 8.1.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	828
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 1, datë 16.1.2025	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	829
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 2, datë 16.1.2025	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	830



UDHËZIM

Nr. 1, datë 15.1.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E PROGRAMEVE
TË FORMIMIT PROFESIONAL QË
PËRFITOJNË NGA MBËSHTETJA
FINANCIARE, PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 2, pika 2, të kreut I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 5.10.2022, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”,

UDHËZOJ:

1. Të përfitojnë nga mbështetja financiare për vitin 2025, programet e formimit profesional në fushën “Programim”.

2. Në fushën “Programim” përfshihen: kodimi, programimi kompjuterik, zhvillimi i aplikacioneve, robotika, elektronika, shkenca e të dhënave, siguria kibernetike, inteligjenca artificiale, testimi i *software*-ve, dizajni i *software*-ve, dizajni i faqeve *web*, dizajni i përvojës së përdoruesit, dizajni i ndërfaqes së përdoruesit, mësimi makinerik/automatik, realiteti i shtuar, realiteti virtual ose algoritmet kompjuterike apo fusha të ngjashme të tjera.

3. Fondet për zbatimin e këtij programi për vitin 2025 të mbulohen nga fondet e programit të nxitjes së punësimit.

4. Udhëzimi nr. 1, datë 11.1.2024, “Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2024”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

URDHËR

Nr. 24, datë 16.1.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datën 17.1.2025, zëvendësministrit të Drejtësisë, z.Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z.Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR

Nr. 35, datë 14.1.2025

**PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë



dhe Zhvillimit Rural, z. Arian Jaupllari, nga data 16.1.2025 deri më datë 19.1.2025.

2. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) Ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) Bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë tek një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

4. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri, z. Arian Jaupllari.

5. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

6. Ky urdhër hartohet në 3 (tre) kopje të njëjta: 1 (një) për arkiv/protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 42, datë 20.1.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë

30.3.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, të deleguara te zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta me urdhër të ministrit të Drejtësisë nr. 54, datë 6.2.2024, “Për autorizimin dhe delegimin e disa kompetencave/autoritetit të ministrit të Drejtësisë zëvendësministrit të Drejtësisë z.Klajd Karameta”, për periudhën 20.1.2025–24.1.2025, delegohen te zëvendësministri i Drejtësisë z.Tedi Dobi.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z.Tedi Dobi, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

VENDIM

Nr. 280, datë 16.12.2024

**MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT
TË BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË
16.12.2019, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS
SË PËRKOHSHE TË TRANSMETIMIT
TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA
‘ALBGAS’ SHA PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13, pika 1, 16, pika 2, 17, germa “e” dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të neneve 15 dhe 21, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2542 prot., datë 13.12.2024, të përgatitur nga



Drejtoria e Gazit Natyror “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, ‘Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2025”’,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 118 prot., datë 11.11.2024 (protokolluar me tonën nr. 223/6 prot., datë 12.11.2024), ka informuar se rrethanat në të cilat ajo zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm si Operator i Sistemit të Transmetimit (OST) të gazit natyror nuk kanë pësuar ndryshime të rëndësishme që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në elementet përcaktuese të metodologjisë së tarifës. Për këtë arsye, shoqëria ka kërkuar që për vitin 2025 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit, e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 367, datë 15.12.2023.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 367, datë 15.12.2023, vendosi: shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s për vitin 2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- Neni 17, germa “e”, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, e ndryshuar, parashikon se: ERE, mund të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rast kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifatat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese.

- Duke pasur parasysh se Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 23.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria “Albgaz” sh.a., i cili përfshin investimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të shoqërisë, si dhe vlerësohet se deri në momentin e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë për miratimin e një tarife transmetimi të gazit natyror, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, bëhet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206 datë 16.12.2019.

- Për arsye se tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë “Albgaz” sh.a., në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe direktivave të

Komunitetit të Energjisë, ku aksesimi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s për vitin 2025, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 296, datë 30.12.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU FOTOVOLTAIK “BLUE 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1,



germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2144/14 prot., datë 27.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2144 prot., datë 16.10.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaike “Blue 2”, me vendndodhje në Sheq Marinas, me kapacitet të instaluar 50 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 28.10.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.10.2024 dhe 31.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me shkresën nr. 2340 prot., datë 4.11.2024. Ndërsa me shkresën me nr. 2144/3 prot., datë 5.11.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2144/4 prot., datë 13.11.2024, e-mailin e datës 4.12.2024 dhe shkresën me nr. 2144/5 prot., datë 06.12.2024, shoqëria ka depozituar informacion / dokumentacion plotësues për aplikimin.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë dhe seancës së mbajtur në ERE më datë 16.12.2024 për sqarimin e dokumentacionit të këtij aplikimi, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin përkatës, i

cili është protokolluar në ERE me shkresat nr. 2144/10 prot., datë 16.12.2024 dhe nr. 2144/11 prot., datë 17.12.2024.

- Në mbledhjen e Bordit të datës 24.12.2024, pas shqyrtimit të relacionit nr. 2144/12 prot., dhe pas sqarimeve të dhëna nga përfaqësuesi i shoqërisë, iu la detyrë të dorëzojë në protokollin e ERE-s dokumentet dhe sqarimet e dhëna gjatë mbledhjes së Bordit. Në këto rrethana, si dhe u vendos të zgjatet me 10 ditë afati për marrjen e vendimit nga Bordi. Më datë 26.12.2024, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin plotësues, i protokolluar në ERE me nr. 2144/13 prot.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k.:

- Ka depozituar vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 183, datë 25.3.2021, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmesë “Blue 2”, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k.;

- Ka depozituar shkresën e MIE-s nr. 4269/1 prot., datë 10.6.2021, me lëndë: “Transferimi i së drejtës për ndërtim” drejtuar shoqërisë “SVP Blue 2” sh.p.k. dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., me të cilën MIE miraton transferimin e së drejtës për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë fotovoltaike “Blue 2”, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në VKM-në nr. 183/2021, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Blessed Investment” sh.p.k. dhe “Matrix Konstruksion” sh.p.k., te shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k.;

- Ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 2721 rep., nr. 2067 kol., datë 9.7.2021, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues



të energjisë elektrike fotovoltaike ‘Blue 2’ me kapacitet të instaluar 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqërisë ‘SPV Blue 2’ sh.p.k.”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaike Blue 2”, me nr. 2391 prot., datë 13.4.2022.

- Është pajisur me VNM paraprake (transferim vendimi nga AN051220200007 – “Blessed Investment” sh.p.k. në AN160720210002 – “SVP Blue 2” sh.p.k.), lëshuar më 3.2.2021 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Parku Fotovoltaike Blue 2”, për shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. Shoqëria ka dokumentuar fillimin e punimeve të ndërtimit të parkut brenda afatit të kësaj VNM-je.

- Në nenin 4 të kontratës nr. 2721 rep., nr. 2067 kol., datë 9.7.2021, të nënshkruar me MIE-n përcaktohet se kontrata lidhet për një afat prej 49 (dyzet e nëntë) vjetësh, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. Megjithatë, ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Duke qenë se në planin e biznesit të shoqërisë është përcaktuar se jetëgjatësia e pritshme e paneleve është 25 vjet dhe nuk është depozituar dokumentacion teknik që garanton jetëgjatësi më të madhe, ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë, deri në 25 vjet, në përputhje me këtë kufizim teknik.

- Shoqëria ka kërkuar që vlefshmëria e licencës të fillojë nga momenti i komisionimit të veprës, duke pasur parasysh se jetëgjatësia e projektit parashikohet të jetë 49 vite, sipas kontratës së nënshkruar me MIE. Bazuar në nenin 9 të kontratës nr. 2721 rep., nr. 2067 kol., datë 9.7.2021, të nënshkruar me MIE-n, ku përcaktohet se mbajtësi i miratimit përfundimtar angazhohet të vërë në funksion Parkun Fotovoltaike “Blue 2” brenda 60 muajve nga marrja e të gjitha lejeve të nevojshme dhe duke marrë parasysh lejen e ndërtimit të datës 17.3.2021, vlerësojmë që vlefshmëria e licencës të

fillojë në momentin e energjizimit të veprës, por jo më vonë se data 17.3.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë e shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaike “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar, duke filluar nga momenti i energjizimit të veprës, por jo më vonë se data 17.3.2026.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 297, datë 30.12.2024

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS SHQIPTARE TË FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE (AAES) PËR DISA NDRYSHIME DHE KUFIZIME NË ZBATIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 186, DATË 6.6.2023

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 33, pika 1, germa “a”, 105 dhe 144, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të neneve 15 dhe 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin



dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore me nr. 2447/6 prot., datë 26.12.2024, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023”,

konstatoi se:

- Shoqata AAES, me anë të shkresës me nr. 2111 prot., datë 21.11.2024, protokolluar në ERE me nr. 2447 prot., datë 25.11.2024, paraqiti kërkesën për zgjatjen e afatit të derogimit të pjesshëm të dispozitave të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022, të ndryshuar me vendimin nr. 186, datë 6.6.2023 dhe së fundmi me vendimin nr. 44, datë 29.3.2024 deri më datë 31.12.2025.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 186, datë 6.6.2023, vendosi të përjashtojë të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2, germat: “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, si dhe në nenet 2.1, 2.2, 4.1 dhe 4.2, të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022 deri më datë 31.12.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) dhe vlerësimit të kushteve të operimit të furnizuesve në tregun e lirë, si dhe nivelit të hapjes dhe liberalizimit të tij, ERE, me vendimin nr. 44, datë 29.3.2024, vendosi, ndër të tjera, që: Furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të liberalizuar, të cilët furnizojnë njëkohësisht më pak se 100 konsumatorë, përjashtohen deri në datën 31.12.2024 nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2, germat: “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, në nenet 2.1 dhe 2.2, si dhe në nenet 4.1 dhe 4.2.

- Sipas të dhënave të raportuara nga Operatorët e Rrjetit të Energjisë Elektrike, rezulton se, për periudhën 1 janar 2024 deri në tetor 2024, numri i

klientëve përfitues nga shërbimi i furnizimit në treg të lirë është 2.203 klientë, nga të cilët 15 klientë janë të lidhur në Sistemin e Transmetimit dhe 2.188 klientë janë të lidhur në Sistemin e Shpërndarjes (në rrjetin 35/20 kV), ku 93 klientë janë të lidhur në rrjetin 35 kw dhe 2095 në rrjetin 20 kV.

- Sipas të dhënave të përpunuara nga ERE mbi raportimet e të licencuarve për zbatimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, rezulton se gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2024, nga 30 furnizues të licencuar, vetëm 8 prej tyre kanë ushtruar aktivitet në tregun e liberalizuar.

- Gjatë vitit 2024 është vërejtur një numër i vogël ankesash nga klientët e furnizuar në tregun e lirë. Më datë 19.12.2024, ERE organizoi një seancë dëgjimore, të thirrur me urdhrin e Kryetarit të ERE-së, datë 11.12.2024. Në këtë seancë morën pjesë përfaqësues të Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) dhe shoqërive “GEN-P” sh.p.k., “FTL” sh.a., “Dragobia Energy Trade” sh.p.k., “KESH” sh.a., “Ener Trade” sh.p.k., dhe “NRG Energy” sh.p.k. Diskutimet u përqendruan në shtyrjen e afatit për zbatimin e dispozitave ligjore të “Rregullores mbi masat për të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, me fokus në përmbushjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit” nga ERE. Gjatë seancës, palët u dakordësuan që furnizuesit e energjisë elektrike që furnizojnë më pak se 100 konsumatorë njëkohësisht të përjashtohen nga detyrimi për zbatimin e masave të përcaktuara në nenin 1.2, germat: “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, si dhe në nenet 2.1, 2.2, 4.1 dhe 4.2, të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit” nga ERE. Në rast të kundërt, këto dispozita do të jenë të zbatueshme. Furnizuesit janë të detyruar të njoftojnë ERE-n sa herë që arrijnë kriterin e furnizimit të 100 konsumatorëve njëkohësisht dhe të dokumentojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në dispozitat e deroguara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e pjesshëm të kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në



zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023.

2. Pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023, ndryshon dhe bëhet:

“Çdo furnizues që operon në tregun e liberalizuar dhe furnizon njëkohësisht të paktën 100 konsumatorë është i detyruar të zbatojë masat e përcaktuara në nenin 1.2, germat: “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, si dhe në nenet 2.1, 2.2, 4.1 dhe 4.2, të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”.”.

3. Të gjithë furnizuesit janë të detyruar të njoftojnë ERE-n sa herë që arrijnë kriterin e furnizimit të 100 konsumatorëve njëkohësisht dhe të dokumentojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në dispozitat e deroguara, brenda 10 ditëve nga plotësimi i këtyre kushteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 300, datë 30.12.2024

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN,
SHLYERJEN DHE ANULIMIN E
GARANCIVE TË ORIGJINËS PËR
ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA BURIMET E
RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin,

funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2645 prot., datë 30.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme “Mbi miratimin e Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 378, datë 28.12.2023, ka miratuar nisjen e procedurës për aprovimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

- ERE ka njoftuar të gjitha palët e interesuara që të shprehin opinionet e tyre lidhur me këtë draftregullore dhe ka publikuar dokumentin në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në seksionin “Konsultime”. Deri në këtë vendimmarrje, nuk janë paraqitur komente nga palët e interesuara mbi këtë draftregullore.

- Në nenin 22, pika 2 e këtij ligji përcaktohet se: ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë dhe siguron përafrimin e politikave dhe parimeve të garancisë së origjinës me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë.

- Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 24/2024, ERE është institucioni kombëtar përgjegjës për lëshimin e garancive të origjinës në Shqipëri dhe për harmonizimin e politikave të tyre me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë. Po ashtu, ligji e detyron ERE-n të integrohet në sistemin rajonal të Komunitetit të Energjisë, duke mundësuar tregtimin e garancive të origjinës me palët kontraktuese, një detyrim që është realizuar përmes nënshkrimit të marrëveshjes për regjistrin elektronik rajonal. Për më tepër, ERE është përgjegjëse për miratimin e rregullave dhe administrimin e regjistrit të garancive të origjinës, siç përcaktohet në këtë ligj.

- Miratimi i rregullores së re është i domosdoshëm për të zbatuar përcaktimet e nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, duke krijuar dhe menaxhuar nga ERE një sistem të



përcaktuar për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës, i cili është zhvilluar nga një shoqëri e përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

- Rregullorja e paraqitur për miratim përmban 25 nene që përcaktojnë kuadrin rregullator për funksionimin e sistemit të garancive të origjinës për energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme. Ajo mbulon autoritetin dhe qëllimin e miratimit, duke synuar krijimin e një sistemi të besueshëm dhe transparent për lëshimin, transferimin dhe revokimin e garancive të origjinës, me trajtim të barabartë për të gjithë prodhuesit. Në këtë rregullore përcaktohen fushëveprimi dhe përkufizimet, regjistri elektronik dhe procedurat për krijimin, modifikimin dhe mbylljen e llogarive. Rregullorja, gjithashtu, përshkruan mënyrën e lëshimit dhe përmbajtjes së certifikatave, matjen dhe korrigjimin e të dhënave, transferimin, tërheqjen, anulimin dhe afatin e vlefshmërisë së certifikatave.

- Në të përfshihen procedurat për njohjen e certifikatave nga palët e tjera, raportimi dhe publikimi i informacionit mbi përdorimin e regjistrit, si dhe transparenca mbi mbajtësit e llogarive. Përcaktohen kostot e regjistrit elektronik, të cilat mbulohen nga prodhuesit e energjisë elektrike në bazë vjetore, si dhe bashkëpunimi me autoritetet ndërkombëtare për informimin e klientëve fundorë mbi përbërjen e energjisë së furnizuar nga burimet e rinovueshme. Në fund, rregullorja trajton zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, rishikimin dhe hyrjen e saj në fuqi.

- Për sa më sipër, vlerësojmë se rregullorja e propozuar për miratim siguron përputhshmërinë me regjistrin elektronik dhe formatin e ri të lëshimit të garancive të origjinës nga ERE, duke synuar krijimin e një tregu funksional të garancive të origjinës që mbështet prodhuesit e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe nxit përdorimin e energjisë së gjelbër nga konsumatorët fundorë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të

njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN, SHLYERJEN DHE ANULIMIN E GARANCIVE TË ORIGINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E RINOVUESHME

Neni 1 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe në përputhje me “Rregulloren e organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore, është të krijojë kuadrin e nevojshëm rregullator për krijimin e një sistemi të saktë, të besueshëm e transparent për lëshimin, transferimin dhe revokimin e garancive të origjinës duke siguruar një trajtim të barabartë e të drejtë, për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, lidhur me lëshimin, transferimin apo revokimin e garancive të origjinës.

Neni 3 Objekti

Kjo rregullore përcakton kriteret, procedurat dhe afatet për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancisë së origjinës (GO), për prodhuesit që shfrytëzojnë burime energjie të rinovueshme siç është përcaktuar në ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe mbajtjen e regjistrit elektronik të certifikatave të garancisë së origjinës.

Neni 4 Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “Ligj” do të thotë ligji nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;

2. “Bordi i ERE-s” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, që funksionon sipas dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;

3. “ERE” është Enti Rregullator i Energjisë;

4. “I licencuar” është një person që mban një licencë të dhënë sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;

5. “Garancia e origjinës (GO)”, është një dokument elektronik, i cili ka funksion të vetëm që t’i provojë konsumatorit fundor se, një pjesë ose e gjithë sasia e energjisë elektrike të përdorur prej tij është prodhuar prej burimeve të rinovueshme;

6. “Aplikant” është çdo person juridik, i cili ka një licencë aktive për prodhimin, tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike dhe paraqet një kërkesë për hapjen e llogarisë në regjistrin elektronik;

7. “Mbajtës i llogarisë” është çdo aplikant, aplikimi i të cilit është pranuar;

8. “Përdorues shtesë” është çdo përdorues tjetër, i cili me kërkesë të aplikantit/mbajtësit të llogarisë i jepet nga autoriteti lëshues i GO-së e drejta për të aksesuar llogarinë e mbajtësit të llogarisë në sistemin elektronik të garancive të origjinës;

9. “Llogari” është një set të dhënash dhe informacioni të gatshëm në regjistrin elektronik me mbajtësin e llogarisë;

10. “Regjistri elektronik” është regjistri i certifikatave të garancisë së origjinës;

11. “Sistem” është sistemi elektronik nëpërmjet të cilit mirëmbahet dhe menaxhohet regjistri i GO; - së

12. “Periudha raportuese” është një muaj kalendarik, nga ora 00:00 e ditës së parë kalendarike deri më 00:00 të ditës së fundit;

13. “Energjia nga burimet e rinovueshme” është energjia nga burime të rinovueshme jofosile, përfshirë energjinë nga era, dielli, energjia aerotermike, energjia gjeotermike, energjia hidrotermike dhe energjia e oqeanëve, energjia hidrike, biomasa, gazi i grumbulluar në landfille, gazi, që grumbullohet nga trajtimi i ujërave të zeza dhe biogazet;

14. “Biomasa” është pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbeturinave dhe mbetjeve me origjinë biologjike nga veprimtaria bujqësore (përfshirë lëndë bimore dhe shtazore), pyjore dhe nga industri të lidhura me to, përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si edhe pjesa e biodegradueshme e mbeturinave industriale, urbane dhe rurale;

15. “Energji gjeotermike” është energjia e depozituar në formën e nxehtësisë nën sipërfaqen e tokës;

16. “Shoqata e Organeve Lëshuese” ose “AIB” – është një organizatë jofitimprurëse që lehtëson certifikimin dhe gjurmimin e energjisë së rinovueshme në të gjithë Evropën. Ajo menaxhon kryesisht Sistemin Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS), një kornizë e standardizuar për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës (GO) dhe certifikatave të tjera të energjisë.

17. “Operatori i Energjisë së Rinovueshme” ose “OER” është pala kontraktuese e prodhuesve me përparësi të kualifikuar për mbështetje në përputhje me ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, nëpërmjet kontratës për mbështetje, ose i mbështetur përmes sistemit të tarifave nxitëse përmes marrëveshjeve për blerjen e energjisë;

18. “Prodhues hibrid” është impianti elektrik, i cili përdor të dyja llojet e burimeve të energjisë, të rinovueshme e jo të rinovueshme, për prodhimin e energjisë elektrike;

19. “Rezervë pompimi” do të thotë një sistem hidroelektrik në të cilin energjia elektrike prodhohet gjatë periudhave të pikut të kërkesës, nga përdorimi i ujit që është pompuar në një rezervuar në një lartësi më të madhe, gjatë periudhave jo të pikut, me kërkesë më të ulët për energji elektrike;

20. “Shlyerja” do të thotë procesi i deklarimit të saktë dhe të verifikueshëm të informacionit lidhur me burimin e energjisë;

21. Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë rregullore, të cilat nuk janë përkufizuar më sipër, do të kenë kuptimin që parashikohet në ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Neni 5

Regjistri i garancive të origjinës

1. Regjistri i garancive të origjinës mbahet dhe administrohet përmes sistemit elektronik nga ERE, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. ERE është organi përgjegjës për saktësinë e të dhënave të regjistrit.

3. Çdo person fizik ose juridik apo subjekt ka të drejtën të aplikojë për t’u regjistruar në regjistrin e garancive të origjinës të ERE-s, duke u kategorizuar sipas roleve të mëposhtme:

3.1 Prodhues i energjisë elektrike, i licencuar nga ERE në përputhje me përcaktimet e nenit 37 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;

3.2 Furnizues/tregtar i energjisë elektrike, i licencuar nga ERE apo nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator;

3.3 Operatori i Energjisë së Rinovueshme, për prodhuesit e energjisë elektrike që përfitojnë masë mbështetëse për blerje të energjisë;

3.4 Tregtar i garancive të origjinës;

3.5 Klient fundor.

4. Për secilin subjekt të regjistruar, ERE do të krijojë një profil i “mbajtësit të llogarisë” në regjistrë, me funksione të veçanta bazuar në kategorinë e tij.

Neni 6

Krijimi i llogarisë në regjistrin e garancive të origjinës

1. Një llogari në regjistrë krijohet në bazë të një aplikimi, formulari i të cilit miratohet nga Bordi i ERE-s dhe publikohet në faqen e internetit.

2. Aplikanti plotëson formularin e aplikimit për krijimin e një llogarie në regjistrin e garancive të origjinës dhe e dërgon në ERE, e cila është organi lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë.

3. Aplikanti, i cili kërkon të regjistrohet në regjistrë si prodhues i energjisë elektrike apo si operator i energjisë së rinovueshme, plotëson formularin e aplikimit për krijimin e një llogarie në regjistrin e garancive të origjinës dhe e dërgon në ERE për miratim, e cila është organi lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë.

4. Formulari i aplikimit përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

4.1 të dhënat e identifikimit:

a) emri/titulli i aplikantit, numri personal/kodi i identifikimit, adresa ligjore dhe/ose aktuale, adresa e postës elektronike dhe numri i telefonit;

b) llojin e veprimtarisë;

c) përdorues/përdorues shtesë dhe kompetencat e tij/saj në regjistrë (nëse kërkohet nga aplikanti);

4.2 gjatë regjistrimit të pajisjeve të prodhimit të energjisë elektrike, për pajisjet e prodhimit duhet të përcaktohet:

a) lloji i teknologjisë dhe burimi i energjisë nga i cili prodhohet energjia elektrike;

b) kapaciteti i instaluar;

c) pikën e matjes;

d) datën e vënies në punë;

e) vendndodhja;

f) llojin e skemës së mbështetjes së investimeve për pajisjet dhe/ose njësinë e energjisë (nëse ka);

g) kërkesa: të përcaktohet nëse është regjistrimi fillestar ose regjistrimi i pajisjeve shtesë të prodhimit.

4.3 referencë për konfidencialitetin e informacionit tregtar (nëse ka);

4.4 listën e dokumenteve që do të paraqiten.

5. ERE, si organi lëshues i GO-së, brenda 15 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës, vlerëson përputhshmërinë e kërkesës së paraqitur, me kërkesat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

6. Nëse aplikimi nuk plotëson kërkesat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, ERE i cakton aplikuesit një afat shtesë të arsyeshëm kohor për të eliminuar mangësitë, por jo më pak se 10 ditë pune. Në rast të mos eliminimit të mangësive brenda afatit të lartpërmendur, kërkesa do të refuzohet. Në një rast të tillë, aplikanti ka të drejtë të riaplikojë tek ERE.



7. ERE, me marrjen e kërkesës për krijimin e një llogarie, verifikon nëse përmbajtja e aplikimit dhe dokumentacioni i dorëzuar plotëson kërkesat e kësaj rregullore dhe informon aplikantin për vendimin përkatës, në përputhje me kërkesat e pikave 7 dhe 8 të këtij neni.

8. Në rast se, ERE konstaton se aplikimi nuk i plotëson kërkesat e parashikuara në këto rregulla, do të refuzojë t'i krijojë një llogari aplikantit dhe do t'i dërgojë një refuzim të arsyetuar atij.

9. Në rast se, ERE konstaton se aplikimi i plotëson kushtet e parashikuara në këtë rregullore, do të krijojë një llogari në regjistër në emër të aplikantit dhe për t'i siguruar akses të plotë në të, do t'i dërgojë në adresën e e-mailit të përcaktuar në formularin e aplikimit:

a) të dhënat e nevojshme për të hyrë në regjistër dhe për të aksesuar llogarinë e tij;

b) të dhënat e përdoruesit/përdoruesve shtesë që hyjnë në regjistër dhe aksesojnë në llogari, duke marrë parasysh rolet përkatëse – nëse është përcaktuar në aplikim.

10. Në vijim të plotësimit të kërkesave të pikës 8 të këtij neni, pas hyrjes së parë të aplikantit në regjistër, atij i caktohet statusi i mbajtësit të llogarisë.

11. Mbajtësi i llogarisë ka të drejtë të shtojë ose heqë një përdorues shtesë në sistem në çdo kohë ose t'ia adresojë kërkesën e mësipërme në mënyrë elektronike ERE-s. Në rastin e marrjes së një kërkesë të tillë, ERE duhet të shtojë/heqë një përdorues shtesë brenda 5 ditëve të punës dhe të informojë aplikantin për këtë, në adresën e postës elektronike ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit të ofruara nga sistemi.

Neni 7

Regjistrimi i pajisjeve të prodhimit të energjisë elektrike

1. Aplikanti/poseduesi i llogarisë, i kategorizuar si prodhues i energjisë elektrike ose si operator i energjisë së rinovueshme në regjistër, ka të drejtë të regjistrojë një ose më shumë pajisje prodhuese nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në këto rregulla.

2. Pajisjet e prodhimit mund të regjistrohen vetëm nëse pajisjet e prodhimit ndodhen në Shqipëri dhe aparati matës i tyre është në përputhje me ligjet në fuqi.

3. Për regjistrimin e pajisjeve të prodhimit të energjisë elektrike, duhet të paraqitet dokumenta-

cioni përkatës që konfirmon të dhënat e parashikuara në pikën 3.2 të nenit 6 të kësaj rregullore.

4. Me regjistrimin e pajisjeve të prodhimit, pronari i pajisjeve prodhuese ose përfaqësuesi i autorizuar deklaron pëlqimin e tij/saj për publikimin e informacionit të parashikuar në këto rregulla për pajisjet e prodhimit.

Neni 8

Modifikimi i të dhënave të regjistruara të mbajtësit të llogarisë

1. Mbajtësi i llogarisë duhet të njoftojë organin lëshues në mënyrë elektronike:

a) Për ndryshimin e të dhënave të regjistrimit të parashikuar në pikën 3.1, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, menjëherë pas implementimit të tyre, por jo më vonë se 3 ditë pune.

b) për ndryshimin e të dhënave të regjistrimit të parashikuara në pikën 3.2, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, të paktën 3 ditë pune përpara zbatimit të ndryshimit, dhe të tregojë datën e saktë të zbatimit të ndryshimit në aplikim. Organi lëshues do të ndalojë lëshimin e certifikatës GO për pajisjet përkatëse të prodhimit në orën 00:00 të datës së specifikuar në aplikim.

2. Në rast ndryshimi të parashikuar në germën “a” të pikës 1 të këtij neni, ERE regjistron ndryshimin në regjistër brenda 5 ditëve pune nga marrja e aplikimit.

3. Mbajtësi i llogarisë i paraqet ERE-s një dokument të lëshuar në përputhje me ligjin, i cili konfirmon implementimin e ndryshimit përkatës dhe datën e tij, ose nëse një ndryshim i tillë nuk është implementuar, i paraqet moszbatimin e tij, menjëherë pas përfundimit të implementimit të ndryshimit të parashikuar në germën “b” të pikës 1 të këtij neni, por jo më vonë se një ditë pune.

4. ERE, si organi përgjegjës bën regjistrimin e ndryshimit në sistem dhe/ose rinovon lëshimin e certifikatës GO brenda 5 ditëve pune pas marrjes së dokumentit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 5 të këtij neni.

5. Kur dokumenti i paraqitur nga mbajtësi i llogarisë në lidhje me implementimin e ndryshimit nuk është lëshuar në përputhje me ligjet në fuqi, ERE do të refuzojë të pasqyrojë ndryshimin në sistem të mbajtësi i llogarisë dhe do të kufizojë transferimin e certifikatës së garancisë së origjinës të



lëshuar në pajisjet përkatëse të prodhimit, për të cilat njofton mbajtësin e llogarisë në mënyrë elektronike. Refuzimi duhet të jetë i justifikuar.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, ERE do të rifillojë lëshimin dhe transferimin e certifikatës së garancisë së origjinës sapo mbajtësi i llogarisë të korrigjojë gabimin. ERE e shqyrton kërkesën e mbajtësit të llogarisë për korrigjimin e gabimit në përputhje me pikën 4 të këtij neni.

7. Në rast se mbajtësi i llogarisë informon ERE për ndryshimet në të dhënat e parashikuara në pikën 3.2 të nenit 6 të këtyre rregullave, pas implementimit të ndryshimeve, ERE, me marrjen e një informacioni të tillë, do të ndalojë lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për pajisjet përkatëse të prodhimit, do të kufizojë transferimin e certifikatave të lëshuara në pajisjet përkatëse të prodhimit dhe do ta shqyrtojë kërkesën në përputhje me pikën 4 të këtij neni. Për më tepër:

a) nëse mbajtësi i llogarisë nuk konfirmon ndryshimet e bëra në përputhje me kërkesat e këtyre rregullave brenda 30 ditëve kalendrike pas njoftimit të ERE, ERE do të ngrijë certifikatën e garancisë së origjinës të lëshuar dhe/ose transferuar të pajisjeve përkatëse të prodhimit;

b) nëse mbajtësi i llogarisë konfirmon ndryshimin, ERE menjëherë pas konfirmimit të ndryshimit do të tërheqë certifikatën GO të lëshuar për pajisjet përkatëse të prodhimit në periudhën raportuese të ndryshimit, si dhe në çdo periudhë raportuese të përfunduar pasuese dhe të rivendosë të drejtën për të lëshuar dhe transferuar certifikatën së garancisë së origjinës të mbajtësi i llogarisë.

8. Nëse si rezultat i ndryshimit, rritet kapaciteti i instaluar i pajisjeve të prodhimit të regjistruara në mënyrë që kapaciteti i shtuar të ketë një pikë matjeje të pavarur, kapaciteti i shtuar regjistrohet në regjistër në përputhje me kërkesat e neneve 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, si pajisje shtesë të prodhimit.

9. ERE njofton mbajtësin e llogarisë për plotësimin ose refuzimin e plotësimit të kërkesave të parashikuara në këtë nen, si dhe informon mbajtësin /mbajtësit përkatës të llogarisë për tërheqjen e certifikatës së garancisë së origjinës në adresën e postës elektronike ose nëpërmjet sistemit, jo më vonë se një ditë pune.

Neni 9

Auditimi i pajisjeve të prodhimit të regjistruara

1. ERE ka të drejtë të verifikojë pajisjet e prodhimit të regjistruara në çdo kohë për të përcaktuar nëse energjia elektrike prodhohet nga pajisjet e prodhimit të energjisë elektrike dhe nëse matja e energjisë elektrike të prodhuar dhe/ose veprime të tjera kryhen në përputhje me informacionin e specifikuar në sistem. Refuzimi dhe/ose ndërhyrja në inspektimin e pajisjeve prodhuese nga pronari i pajisjeve prodhuese ose përfaqësuesi i autorizuar do të konsiderohet shkelje e këtyre rregullave.

2. ERE do të njoftojë përfaqësuesin e pajisjes prodhuese nëpërmjet postës elektronike për kohën e saktë të inspektimit të paktën 2 ditë pune përpara.

3. ERE harton një procesverbal menjëherë pas kontrollit të pajisjes prodhuese të regjistruar. Procesverbali nënshkruhet nga përfaqësuesi përkatës i ERE-s dhe përfaqësuesi i pajisjes prodhuese të regjistruar, nëse në inspektim është i pranishëm përfaqësuesi i pajisjes së regjistruar prodhuese. ERE do t'i dërgojë një kopje të procesverbalit të inspektimit pronarit të pajisjes prodhuese në adresën e postës elektronike brenda 2 ditëve të punës nga përgatitja e tij.

4. Në procesverbalin e inspektimit, ERE duhet të tregojë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe të dhënat e identifikimit të pajisjes prodhuese;

b) pronari i pajisjes prodhuese;

c) mbajtësin e llogarisë;

d) datën e inspektimit;

e) të dhënat teknike, të cilat tashmë janë verifikuar;

f) rezultatin e inspektimit;

g) personi/personat që kanë kryer inspektimin dhe nënshkrimi i tyre;

h) datën e hartimit të procesverbalit.

Neni 10

Kërkesa për mbyllje të llogarisë nga mbajtësi i llogarisë

1. Mbajtësi i llogarisë ka të drejtë, 30 ditë pune pas hapjes së llogarisë, të aplikojë në mënyrë elektronike te ERE, me kërkesën për mbylljen e llogarisë së tij.



2. ERE, si organi lëshues i garancive të origjinës, mbyll llogarinë brenda 10 ditëve pune nga marrja e aplikimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni dhe dërgon një njoftim në adresën e postës elektronike të mbajtësit të llogarisë. Para anulimit të llogarisë, mbajtësi i llogarisë do të transferojë certifikatën e garancisë së origjinës të një mbajtës tjetër llogarie, përndryshe certifikata e garancisë së origjinës në fjalë do të anulohet nga ERE.

3. ERE nuk do të jetë përgjegjëse për rimbursimin e ndonjë tarife të paguar tashmë nga mbajtësi i llogarisë.

Neni 11

Përmbajtja e certifikatës së garancisë së origjinës

Certifikata e garancisë së origjinës përfshin të dhënat e mëposhtme:

a) burimin e energjisë nga i cili prodhohet energjia elektrike, si dhe datën e fillimit dhe përfundimit të prodhimit të saj;

b) të dhënat identifikuese, vendndodhjen, llojin dhe kapacitetin e pajisjes që prodhon energji elektrike;

c) datën e lëshimit të certifikatës së origjinës, vendin e lëshimit dhe numrin unik të identifikimit;

d) referencë për faktin se certifikata është lëshuar për 1 MWh energji elektrike.

Neni 12

Lëshimi i certifikatës së garancisë së origjinës

1. Garancia e origjinës për një impiant prodhues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lëshohet me bazë mujore.

2. Për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës, pajisja e prodhimit duhet të jetë e vendosur në territorin e Shqipërisë, të ketë një licencë prodhimi të dhënë nga ERE (përfshijë prodhuesit me kapacitet të instaluar deri në 1 MW) dhe të jetë i regjistruar në regjistrin elektronik të garancive të origjinës së ERE-s.

3. ERE i lëshon në sistem mbajtësit të llogarisë, certifikatën e garancisë së origjinës, në mënyrë elektronike, jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas paraqitjes së kërkesës për lëshimin e garancisë së origjinës.

4. Certifikata e garancisë së origjinës do të lëshohet mbajtësit të llogarisë për çdo MWh energji elektrike të prodhuar nga pajisjet përkatëse të prodhimit, duke marrë parasysh të dhënat e matjes të marra në përputhje me kërkesat e këtyre rregullave dhe ligjeve në fuqi.

5. Nuk lejohet të lëshohet certifikata e garancisë së origjinës:

a) për energjinë elektrike të prodhuar për të cilën tashmë është lëshuar certifikata e garancisë së origjinës;

b) për energjinë elektrike të kërkuar për konsum vetjak nga pajisjet e prodhimit.

6. Për çdo njësi të energjisë elektrike të prodhuar (MWh) do të lëshohet vetëm një certifikatë e garancisë së origjinës.

7. Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

8. Garancia e origjinës do të lëshohet me kërkesë të prodhuesit të energjisë nga burimet e rinovueshme vetëm një herë për një sasi neto njësie prej 1 MWh të energjisë elektrike të prodhuar e të matur në pikën e lidhjes me sistemin e transmetimit, shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes. Sasitë mujore të prodhimit të energjisë elektrike rrumbullakosen në MWh dhe sasitë e mbetura grumbullohen në muajt në vijim deri sa ato arrijnë 1 (një) MWh. E njëjta njësi e energjisë nga burimet e rinovueshme merret në konsideratë vetëm një herë.

9. Kur një prodhues me përparësi përfiton nga masat mbështetëse sipas ligjit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, vlera e përfituar nga tregtimi i garancisë së origjinës për të njëjtin prodhim duhet të kthehet tek OER-ja.

10. Në rast se prodhuesi përfiton masë mbështetëse për blerje të energjisë, garancia e origjinës i lëshohet OER-së.

Neni 13

Të dhënat e matjes dhe korrigjimi i të dhënave

1. Certifikata e garancisë së origjinës do të lëshohet nga ERE bazuar në të dhënat e matjes të regjistruara në sistemin e operatorëve të rrjetit të energjisë elektrike.

2. Në rast të korrigjimit të të dhënave të matjes së energjisë elektrike, ERE:



a) në rast të lëshimit të një numri më të madh të certifikatave të garancisë të origjinës, do të zbresë në periudhën e ardhshme raportuese numrin e certifikatave të garancisë së origjinës të lëshuara tepër;

b) në rast të lëshimit të një numri më të vogël të certifikatave të garancisë të origjinës, do të shtojë në periudhën e ardhshme raportuese numrin e certifikatave të garancisë të origjinës që nuk janë lëshuar për shkak të të dhënave të pasakta të matjes.

3. ERE do të informojë mbajtësin e llogarisë brenda 3 ditëve të punës për korrigjimin e të dhënave matëse, arsyen e korrigjimit, të dhënat e matjes që janë korrigjuar dhe numrin e certifikatave të garancisë të origjinës, që do të lëshohen në periudhën e ardhshme raportuese si rezultat i korrigjimit.

4. Çdo sasi e mbetur e energjisë elektrike e identifikueshme nga të dhënat e matjes do t'i shtohet certifikatave të garancisë të origjinës të energjisë elektrike, që do të lëshohet në të njëjtën ose çdo periudhë raportuese pasuese deri në përfundimin e një MWh.

Neni 14

Transferimi i certifikatave të garancisë së origjinës

1. Certifikata e garancisë të origjinës të energjisë elektrike do të transferohet nga një mbajtës llogarie te një mbajtës llogarie tjetër në bazë të kërkesës së dorëzuar në sistem ERE-s nga mbajtësi i certifikatës së garancisë të origjinës, në të cilën tregohet informacioni i mëposhtëm:

a) numri i certifikatës së garancisë të origjinës që do të transferohet;

b) emrin/titullin e mbajtësit të llogarisë marrëse dhe të dhënat e identifikimit të llogarisë së tij/saj.

2. ERE konfirmon kërkesën për transferimin e certifikatës së origjinës, jo më vonë se 5 ditë pune pas marrjes së saj.

3. ERE do të refuzojë kërkesën për transferimin e certifikatës së garancisë së origjinës te mbajtësi i llogarisë marrëse, nëse ajo nuk plotëson kërkesat e parashikuara në këto rregulla ose nëse sistemi ka një defekt teknik. Në rast refuzimi ose pamundësie për të transferuar certifikatën e garancisë së origjinës, kërkuesi i transferimit do të marrë një mesazh automatik në sistem për pamundësinë për të pasqyruar ose transferuar certifikatën e garancisë së

origjinës në llogarinë e marrësit, duke treguar arsyen, për të cilën certifikata e garancisë së origjinës mbetet në llogarinë ekzistuese.

4. Pas transferimit të suksesshëm të certifikatës së origjinës, një mesazh automatik do t'i dërgohet dërguesit të certifikatës së garancisë të origjinës, si dhe marrësit të saj.

5. Certifikata e garancisë së origjinës e anuluar ose e skaduar nuk mund t'i nënshtrohet transferimit.

Neni 15

Tërheqja e certifikatës së garancisë së origjinës nga regjistri

1. ERE e tërheq certifikatën e garancisë së origjinës të lëshuar dhe/ose të transferuar nga regjistri me iniciativën e tij ose me kërkesë të mbajtësit të llogarisë, nëse:

a) informacioni i parashikuar në nenin 11 të kësaj rregullore është pasqyruar gabim në certifikatën e garancisë së origjinës;

b) certifikata e garancisë së origjinës është lëshuar në bazë të të dhënave të pasakta nga pikat matëse të pajisjeve prodhuese;

c) në rastet e parashikuara drejtpërdrejt nga kjo rregullore.

2. Kur ndodhin rrethanat e parashikuara në germenat "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij neni, ERE do të ndalojë menjëherë, jo më vonë se një ditë pune, lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për pajisjet e prodhimit, duke kufizuar mbajtësin e llogarisë nga transferimi i certifikatës GO të lëshuar në pajisjet përkatëse të prodhimit dhe të kërkojë nga regjistri certifikatat përkatëse të garancisë së origjinës. ERE, jo më vonë se një ditë pune, do të njoftojë mbajtësin përkatës të llogarisë për sa më sipër, menjëherë pasi të ketë kërkuar certifikatën e garancisë së origjinës.

3. Për të rivendosur lëshimin dhe transferimin e certifikatës GO në përputhje me pikën 2 të këtij neni, mbajtësi i llogarisë përkatëse duhet t'i drejtohet ERE dhe të dorëzojë një dokument që konfirmon korrigjimin e gabimit, përveç rasteve kur gabimi në fjalë është shkaktuar nga gabimi i organit lëshues. ERE e shqyrton kërkesën në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

4. Në rast se tërheqja e certifikatës e garancisë së origjinës është për shkak të një gabimi nga ERE, ajo do të ndalojë lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për pajisjet e prodhimit derisa gabimi të



korrigjohet, do t'i kufizojë mbajtësit të llogarisë transferimin e certifikatës së garancisë së origjinës të lëshuar për pajisjet përkatëse të prodhimit dhe do të ndërrojë menjëherë të dhënat e regjistruara në sistem, nëse gabimi është shkaktuar nga hedhja e gabuar e të dhënave në sistem. ERE duhet të njoftojë mbajtësin/mbajtësit e llogarisë përkatëse brenda një dite pune.

5. Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, ERE do të lëshojë numrin përkatës të certifikatës së garancisë së origjinës të korrigjuar në periudhën e ardhshme raportuese, për vëllimin e certifikatave të garancisë së origjinës të kërkuara, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3 të nenit 13 të kësaj rregulloreje.

6. ERE do të kërkojë tërheqjen e certifikatës së garancisë së origjinës, pavarësisht nëse informacioni mbi pjesën ose sasinë e energjisë elektrike të prodhuar dhe të dorëzuar me këtë certifikatë është dhënë apo jo.

7. Në rast se certifikata e garancisë së origjinës tërhiqet nga ERE, ajo do të hiqet nga sistemi.

Neni 16

Anulimi i certifikatës së garancisë së origjinës

1. Anulimi i certifikatës së garancisë së origjinës është heqja e një certifikate nga qarkullimi. Pasi të anulohet, një certifikatë nuk mund të zhvendoset në asnjë llogari tjetër, dhe kështu nuk është më e tregtueshme.

2. Certifikata e garancisë së origjinës do t'i nënshtrohet anulimit nëse është deklaruar.

3. Mbajtësi i llogarisë përkatëse do të kërkojë anulimin e certifikatës së garancisë së origjinës përmes sistemit, menjëherë pas momentit të deklarimit të origjinës së energjisë elektrike nga certifikata e garancisë së origjinës.

4. Certifikata e garancisë së origjinës do të anulohet brenda 5 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës për anulim në sistem.

Neni 17

Afati i skadimit të certifikatës së garancisë së origjinës

1. Certifikata e garancisë së origjinës do të përdoret brenda 12 muajve nga prodhimi i energjisë përkatëse. Për qëllimet e këtyre rregullave, data e

lëshimit të certifikatës së origjinës do të konsiderohet të jetë sipas energjisë së prodhuar.

2. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, certifikata e garancisë së origjinës do t'i nënshtrohet fshirjes automatike nga sistemi.

3. ERE duhet të informojë mbajtësin e llogarisë për skadimin e certifikatës së garancisë së origjinës të paktën 30 ditë kalendrike para skadimit. Certifikata e garancisë së origjinës do t'i nënshtrohet anulimit automatik, pavarësisht nëse ERE i ka dërguar mbajtësit të llogarisë informacion për datën e skadimit.

Neni 18

Njohja e certifikatës së garancisë së origjinës të lëshuar nga palë të tjera

1. Certifikata e garancisë së origjinës e lëshuar nga një Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose vendi anëtar i Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), do të njihet në Shqipëri nga Bordi i ERE-s me iniciativën e tij ose në bazë të kërkesës së një pale të interesuar, duke u bazuar në vlerësimin e akteve rregullatore për njohjen e certifikatave të garancisë së origjinës të atij vendi.

2. Njohja e certifikatës së garancisë së origjinës nga Bordi i ERE-s nënkupton konfirmimin e përputhshmërisë së certifikatës së lëshuar nga pala përkatëse kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose vendi anëtar i Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), me kërkesat e parashikuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje. Për të konfirmuar pajtueshmërinë, Bordi i ERE-s do të vlerësojë kushtet e lëshimit, transferimit, shlyerjes dhe anulimit të certifikatës së garancisë së origjinës nga Pala Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose nga një vend anëtar i Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), duke përfshirë masën në të cilën këto kushte sigurojnë parandalimin e lëshimit, transferimit të përsëritur ose deklarimit të certifikatës së garancisë së origjinës që tashmë është lëshuar, transferuar ose deklaruar.

3. Certifikata e garancisë së origjinës e lëshuar nga një Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose nga një vend anëtar i Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), do të njihet një herë dhe do të zbatohet për të gjitha certifikatat GO të lëshuara nga vendi përkatës.

4. Kur një palë e interesuar aplikon për njohje të certifikatës së garancisë së origjinës, kjo palë duhet të tregojë në aplikim kushtet e vendosura për



lëshimin, transferimin, anulimin dhe zbardhjen e certifikatës së garancisë së origjinës nga vendi përkatës dhe duhet të bashkëngjis përkthimin zyrtar të aktit/akteve rregullatore që rregullojnë këto kushte nga Pala Kontraktuese përkatëse, në gjuhën shqipe.

5. Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, Bordi i ERE-s shqyrton aplikimin sipas procedurës së përcaktuar nga ligjet në fuqi.

6. Bordi i ERE-s ka të drejtë të refuzojë njohjen e certifikatës GO vetëm nëse ka dyshime të arsyeshme për saktësinë, besueshmërinë ose vërtetësinë e certifikatës së garancisë së origjinës përkatëse. ERE njofton aplikantin dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për çdo refuzim së bashku me arsyet për këtë refuzim. ERE do të marrë parasysh çdo opinion të sekretariatit të komunitetit të energjisë për njohjen e garancive të origjinës dhe do të japë me shkrim arsyet për çdo devijim. Bordi i ERE-s njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e tij përfundimtar, në përputhje me rekomandimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për njohjen ose refuzimin e certifikatës së garancisë së origjinës dhe e publikon atë në faqen e tij të internetit.

7. Kur Bordi i ERE-s njih certifikatën e garancisë së origjinës të lëshuar nga Pala Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ose nga një vend anëtar i Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), lista e shteteve të cilave u është njohur certifikata e garancisë së origjinës do të publikohet në faqen e internetit të ERE-s.

8. Bordi i ERE-s do të fillojë procedurën për të rishikuar çështjen e njohjes së certifikatës së garancisë së origjinës të lëshuar nga Pala Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe do të veprojë në përputhje me kërkesat e paragrafit 6 të këtij neni, nëse ka një ndryshim në aktet rregullatore që rregullojnë certifikatën e garancisë së origjinës të Palës Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, të cilat mund të vënë në pikëpyetje saktësinë, besueshmërinë ose vërtetësinë e certifikatës së garancisë së origjinës.

Neni 19

Raporti vjetor i garancive të origjinës

1. ERE harton një raport vjetor brenda datës 30 prill të çdo viti, për përdorimin e regjistrit të

garancive të origjinës gjatë vitit paraardhës dhe e publikon atë në faqen e saj të internetit.

2. Raporti vjetor përfshin:

a) numrin e plotë të aplikimeve, duke përfshirë sasitë e pranuar dhe të papranuara, me cilësimin e personave që kryejnë veprimtaritë përkatëse;

b) numrin e certifikatave të garancisë së origjinës të lëshuara, duke cilësuar sasinë përkatëse të energjisë elektrike;

c) numrin e refuzimeve për të transferuar certifikatën e garancisë së origjinës, duke cilësuar sasinë përkatëse të energjisë elektrike;

d) numrin e certifikatave të garancisë së origjinës të transferuara, duke cilësuar sasinë përkatëse të energjisë elektrike;

e) numrin e certifikatave të garancisë së origjinës të anuluar, duke cilësuar sasinë përkatëse të energjisë elektrike;

f) numrin e certifikatave të garancisë së origjinës të tërhequra, duke cilësuar sasinë përkatëse të energjisë elektrike;

g) numrin e certifikatave të garancisë së origjinës të skaduar, duke cilësuar sasinë përkatëse të energjisë elektrike;

h) informacione të tjera që ERE i konsideron të nevojshme për raportim dhe nuk përfaqësojnë informacion konfidencial.

Neni 20

Raportimi dhe publikimi i informacionit

1. Drejtoria përgjegjëse për garancitë e origjinës raporton pranë Bordit të ERE-s çdo muaj lidhur me certifikatat e garancisë së origjinës së lëshuara, transferuara, tërhequra, anuluar dhe skaduar.

2. ERE publikon informacionin e mëposhtëm në faqen e tij të internetit:

a) emrin e mbajtësve të llogarisë në regjister dhe numrin e identifikimit të llogarisë së tyre;

b) pajisja e prodhimit:

i. emri;

ii. burimi i energjisë;

iii. teknologjia;

iv. kapaciteti i instaluar;

v. data e fillimit të operimit;

vi. vendndodhja;

c) raportin vjetor të garancive të origjinës;

d) rregulloren në fuqi.

3. ERE, në rast se bën një ndryshim në informacionin që do të publikohet në faqen e saj të



internetit, siç parashikuar në këtë rregullore, publikon informacionin e përditësuar në faqen e internetit brenda 2 ditëve pune pas kryerjes së ndryshimit ose konfirmimit të ndryshimit.

Neni 21

Kostot e regjistrimit elektronik

1. ERE, si organi lëshues i certifikatave të garancisë së origjinës në Republikën e Shqipërisë, do të transferojë koston e mbajtjes, përditësimit dhe administrimit të regjistrimit elektronik të garancive të origjinës të mbajtësit e llogarisë, të cilët do të përfitojnë certifikatën e garancisë së origjinës.

2. Kostoja e regjistrimit elektronik të garancive të origjinës do të llogaritet për njësi (Mwh) të garancisë së origjinës.

3. Kostoja për njësi do të jetë e barabartë me totalin e sasisë përkatëse të energjisë elektrike për të cilën është lëshuar certifikata e garancisë së origjinës në vitin paraardhës ndaj kostove vjetore të regjistrimit elektronik.

4. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë së origjinës, ERE do të dërgojë të mbajtësi i llogarisë të cilit i lëshohet certifikata, vlerën e detyrimit që duhet të paguajë ndaj ERE-s.

5. Kostoja për njësi do të jetë me bazë vjetore dhe do të miratohet me vendim të Bordit të ERE-s jo më vonë se data 31 janar e çdo viti.

6. Çdo diferencë e krijuar në të ardhura nga parashikimi i pikës 3 të këtij neni, do të korrigjohet në vitin pasardhës.

7. Përfundimisht, për vitin 2025, vlera e detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës do të jetë e barabartë me 0.03 euro/MWh.

Neni 22

Bashkëpunimi me autoritetet e tjera

ERE-ja bashkëpunon me të gjitha autoritetet që lëshojnë garanci të origjinës në vendet anëtare të BE-së dhe me palët kontraktuese të komunitetit të energjisë, me qëllim që të vërë në dispozicion për klientët fundorë informacionin për pjesën e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë në totalin e energjisë së furnizuar.

Neni 23

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet Mbajtësve të llogarive dhe ERE në lidhje me zbatimin, interpretimin ose integrimin e rregullave të funksionimit të regjistrimit elektronik, mbajtësi i llogarisë do të paraqesë një ankesë me shkrim në ERE, e cila do të shqyrtohet brenda 30 ditëve nga ERE.

2. Pas trajtimit nga ERE të ankesës së paraqitur, mbajtësi i llogarisë mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.

3. Në rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet dy palëve, ku arsyeja e mosmarrëveshjes është një gabim ose gabim teknik nga ana e ERE-s, duhet t'i njoftohet ERE-s me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 24

Ndryshimi i rregullores

Kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit, në përputhje me “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore u miratua me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024 dhe hyn në fuqi pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

VENDIM**Nr. 301, datë 30.12.2024****MBI DHËNIEN E GARANCISË SË
ORIGINËS PËR ENERGJINË
ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA HEC-
et E KASKADËS SË LUMIT DRIN PËR
PERIUDHËN 1.10.2023–30.9.2024**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 7 dhe 11, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës



për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2124/2 prot., datë 30.12.2024, të Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të Energjisë “Mbi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin për periudhën 1.10.2023–30.9.2024”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” “KESH” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 5081 prot., datë 11.10.2024, ka paraqitur kërkesën për pajisjen me garancinë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës, në periudhën 1.10.2023–30.9.2024.

- Referuar shkresës së paraqitur nga “KESH” sh.a., sasia totale e energjisë elektrike të prodhuar nga HEC “Fierzë”, “Koman” dhe “Vau i Dejës” gjatë periudhës 1.10.2023–30.9.2024 është 4,199 gwh, e ndarë përkatësisht në 1,343 gwh nga HEC Fierzë, 1,886 gwh nga HEC Koman dhe 970 gwh nga HEC Vau i Dejës.

- Referuar nenit 14.2, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për Certifikatë Garancie Origjine do të depozitojë, për qëllime të këtij aplikimi, vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

- “KESH” sh.a. është pajisur me certifikatë të garancisë së origjinës për sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga HEC “Fierzë”, HEC “Koman” dhe HEC “Vau i Dejës” për periudhën 1.10.2022 deri më 30.9.2023, respektivisht me vendimet e Bordit të ERE-s nr. 346, nr. 347 dhe nr. 348, datë 22.11.2023.

- Pavarësisht se shoqëria “KESH” sh.a. ka paraqitur dokumentacionin teknik për të tre HEC-et, vlerësojmë se dokumentacioni fillestar i dorëzuar

në ERE për certifikatën e garancisë së origjinës mbetet i pandryshuar.

- Në vijim të kërkesës së shoqërisë “KESH” sh.a., bazuar në pikën 6, të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE i është drejtuar “OST” sh.a. me anë të një *email*-i zyrtar, duke kërkuar informacion mbi sasinë faktike të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC “Fierzë”, HEC “Koman” dhe HEC “Vau i Dejës” për periudhën 1.10.2023–30.9.2024.

- Në përgjigje, “OST” sh.a., me shkresën nr. 8225 prot., datë 23.12.2024, ka raportuar se për periudhën 1.10.2023–30.9.2024, energjia e prodhuar bruto është: 1,334,419 mwh nga HEC “Fierzë”, 1,869,801 mwh nga HEC “Koman” dhe 960,870 mwh nga HEC “Vau i Dejës”.

- Në zbatim të nenit 11.4, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin nr. 229, të Bordit të ERE-s, datë 20.12.2019, të ndryshuar, përcaktohet se garancia e origjinës duhet të përdoret brenda 12 muajve nga data e prodhimit të energjisë. Në këtë kuadër, ERE do të shqyrtojë kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin për periudhën 1.12.2023–30.9.2024.

- Bazuar në të dhënat e siguruar nga “OST” sh.a., sasinë e energjisë elektrike të prodhuara nga HEC “Fierzë” (1,206,601 mwh), HEC “Koman” (1,569,756 mwh) dhe HEC “Vau i Dejës” (802,722 mwh) do të përdoren për lëshimin e garancisë së origjinës, në përputhje me përcaktimet e nenit 11, të rregullores, i cili specifikon se garancia e origjinës lëshohet për çdo njësi prej 1 mwh.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 22, pikës 5, të ligjit nr. 24/2023, garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Fierzë” për periudhën 1.12.2023–30.9.2024, e ndarë sipas muajve, si vijon:



Dhjetor 2023	149,521	mwh
Janar 2024	125,342	mwh
Shkurt 2024	151,861	mwh
Mars 2024	80,188	mwh
Prill 2024	44,055	mwh
Maj 2024	99,960	mwh
Qershor 2024	132,689	mwh
Korrik 2024	186,220	mwh
Gusht 2024	148,433	mwh
Shtator 2024	88,332	mwh

2. Dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Koman” për periudhën 1.12.2023–30.9.2024, e ndarë sipas muajve, si vijon:

Dhjetor 2023	231,529	mwh
Janar 2024	212,507	mwh
Shkurt 2024	177,102	mwh
Mars 2024	137,986	mwh
Prill 2024	104,530	mwh
Maj 2024	132,017	mwh
Qershor 2024	125,718	mwh
Korrik 2024	176,094	mwh
Gusht 2024	151,755	mwh
Shtator 2024	120,519	mwh

3. Dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Vau i Dejës” për periudhën 1.12.2023–30.9.2024, e ndarë sipas muajve, si vijon:

Dhjetor 2023	121,563	mwh
Janar 2024	114,672	mwh
Shkurt 2024	90,719	mwh
Mars 2024	73,157	mwh
Prill 2024	55,716	mwh
Maj 2024	69,192	mwh
Qershor 2024	58,929	mwh
Korrik 2024	84,177	mwh
Gusht 2024	71,491	mwh
Shtator 2024	63,105	mwh

4. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

5. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të Energjisë të njoftojë shoqërinë “KESH” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të

bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 10, datë 8.1.2025

MBI PËRCAKTIMIN ÇMIMIT TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT E SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT PËR PERIU DHËN 1 SHKURT 2025–31 DHJETOR 2025

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa “c”, 21 dhe nenit 83, dhe 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; të neneve 15 dhe 22, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.1.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 13 prot., datë 6.1.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e shërbimit universal për periudhën 1 shkurt–31 dhjetor 2025”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke u bazuar në analizën e të dhënave tekniko-ekonomike nga “FSHU” sh.a., si dhe në mungesën e të dhënave përfundimtare mbi çmimin e furnizimit nga “KESH” sh.a. për vitin 2025, për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit të klientëve të



shërbimit universal dhe kategorisë “Furra buke / prodhim mielli” deri në përfundimin e procedurave përkatëse të rivlerësimit të kostove, si dhe pas vlerësimit të kryer mbi mjaftueshmërinë e të ardhurave nga aktiviteti i Furnizuesit të Shërbimit Universal, me vendimin nr. 298, datë 30.12.2024, vendosi të zgjasë deri më 31.1.2025 fuqinë juridike të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, për çmimet me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë të shërbyer nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, dhe nr. 72, datë 15.4.2024, për çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët e kategorisë “Furra buke/prodhim mielli” të lidhur në tensionin 0.4 kV.

- “FSHU” sh.a., në vijim të korrespondencave, në lidhje me përcaktimin/vlerësimin e kostove për qëllime të përcaktimit të shitjes së energjisë elektrike, me korrespondencën e datës 31.12.2024, depozitoi në ERE “Kërkesën për rivlerësim të kostove që përcaktojnë Çmimin me Pakicë për klientët e shërbimit universal nga 1 shkurt 2025”. Në këtë kërkesë, “FSHU” sh.a. informon se çmimi i furnizimit nga “KESH” sh.a. për klientët që furnizohen në kushtet e shërbimit universal për vitin 2025 do të ulet nga 2.6 lekë/kwh në 2.34 lekë/kwh, duke argumentuar se kjo kërkesë lidhet me përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë dhe perspektivën pozitive për vitin 2025.

- Shoqëria, së bashku me kërkesën për rivlerësimin e kostove, ka paraqitur një vlerësim mbi treguesit ekonomik duke përfshirë: pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve paraprake për vitin 2023, pritshmëritë për mbylljen e vitit 2024, parashikimet për të ardhurat, shpenzimet dhe sasinë e energjisë elektrike për vitin 2025, si dhe planin e sasisë së energjisë elektrike që pritet të furnizohen klientët që shërbehen nga “FSHU” sh.a.

- Për vitin 2025, shoqëria parashikon që klientët në tensionin 10 kV (me përjashtim të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve) të furnizohen në tregun e lirë. Sasia totale e energjisë elektrike që pritet të shitet për klientët e “FSHU” sh.a. parashikohet të arrijë 5,343 gwh, duke shënuar një rritje prej 0.7% krahasuar me vitin 2024. Të gjithë klientët e shërbimit universal, të lidhur në tensionin 0.4 kV, do të sigurojnë energji nga “KESH” sh.a. me çmimin 2.34 lekë/kwh, ndërsa klientët në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit do të sigurojnë energji nga “KESH” sh.a. me çmimin 12 lekë/kwh.

- “FSHU” sh.a., në kuadër të rivlerësimit të kostove, ka propozuar çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1 shkurt–31 dhjetor 2025. Sipas propozimit, çmimi do të jetë 8.5 lekë/kwh për konsumatorët familjarë që konsumojnë deri në 700 kwh/muaj dhe 9.5 lekë/kwh për ata që konsumojnë sasinë prej 701 kwh e më tej, për të gjithë sasinë e konsumuar duke filluar nga kwh i parë. Ndërkohë, çmimet për konsumatorët privatë propozohet të mbeten të pandryshuara.

- FSHU-ja është shprehur se çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike për klientët e shërbimit universal do të ulet nga 10.83 në 10.23 lekë/kwh.

- ERE, për efekt të kontrollit të të dhënave, kreu rilogaritjen e treguesve të kostove për klientët e shërbimit universal, dhe u identifikua një gabim material nga “FSHU” sh.a. në përlllogaritjen e çmimit mesatar të energjisë për klientët në shërbimin universal për vitin 2025, i cili nga 10.23 lekë/kwh rezultoi 10.24 lekë/kwh.

- Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura nga shoqëria dhe në përputhje me përcaktimet e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 189, datë 23.11.2017, ERE ka kryer vlerësimet/pranimet e saj mbi të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë për periudhën ushtrimore 2024, duke u mbështetur në të dhënat paraprake të paraqitura në kërkesën përkatëse.

- Mbështetur në vlerësimet dhe përlllogaritjet e bazuara në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, ERE ka analizuar dhe pranuar të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura nga “FSHU” sh.a. për vitin 2025. Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në tensionin 0.4 kV është përcaktuar në vlerën 10.24 lekë/kwh, duke siguruar të ardhurat e nevojshme për mbulimin e kostove dhe vijimin e aktivitetit të shoqërisë.

- Objektivi i normës së arkëtimit për vitin 2025 do të jetë në përputhje me atë të përcaktuar në VKM-në nr. 253, datë 24.4.2019, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik”, të ndryshuar.



- Pas përlogaritjeve përkatëse të të ardhurave që priten të realizohen prej çmimeve të propozuara nga “FSHU” sh.a., sipas analizës së mësipërme, dhe duke marrë në konsideratë shpërndarjen e konsumit për secilën kategori klientësh, bazuar në strukturën e shitjeve 11-mujore të vitit 2024, rezulton se çmimet e propozuara realizojnë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar kostot/të ardhurat e kërkuara për periudhën 1 shkurt–31 dhjetor 2025.

- “FSHU” sh.a. duhet të paraqesë në ERE aplikimin për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë, sapo të disponojë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të audituara. Ky aplikim duhet të jetë në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në: “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, “Sistemin e standardizuar të llogarive për të licencuarit”, si dhe “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”.

- Në rast se ERE do të konstatojë ndryshime në komponentët përlogaritës të të ardhurave të kërkuara të “FSHU” sh.a., do të kryej korrigjimet përkatëse bazuar në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, për periudhën 1 shkurt 2025–31 dhjetor 2025, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në rast se të ardhurat e realizuara devijojnë mbi ose nën nivelin e lejuar, do të kryhet korrigjimi dhe kompensimi përkatës, në përputhje me nenin 20, germa “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe metodologjitë përkatëse të miratuara nga ERE.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë “FSHU” sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL, PËR PERIUDHËN 1 SHKURT–31 DHJETOR 2025

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL, PËR PERIUDHËN 1 SHKURT- 31 DHJETOR 2025		
Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive (Lekë/kWh)	**Çmimi i energjisë aktive në orar pik (Lekë/kWh)
Klientë të lidhur në 0.4 kV	14 Lekë/ kWh	16.1 Lekë/ kWh
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV:		
Kategoria I- Furra buke/ Prodhim mielli në 0.4 kV	7.6 Lekë/ kWh	8.74 Lekë/kWh
Kategoria II - Furrë buke, produkte mielli shoqëruese dhe pastiçeri në 0.4 kV	9.5 Lekë/kWh	10.93 Lekë/kWh
Kategoria III - Furrë buke, produkte mielli shoqëruese dhe pastiçeri, shërbim kafe në 0.4 kV	12 Lekë/kWh	13.80 Lekë/kWh
Objekte kulturi dhe bashkësi fetare	9.5 Lekë/kWh	
Familjarë:		
Konsumatorët familjarë që konsumojnë deri në 700 kWh në muaj	8.5 Lekë/kWh	
Konsumatorët familjarë që konsumojnë më shumë se 700 kWh në muaj	* 9.5 Lekë/kWh	
Çmimi për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (Ndriçim shkalle, pompë, ashensor,)	9.5 Lekë/kWh	
<i>* Për konsumatorët familjarë të cilët konsumojnë 701 kWh në muaj e më tej, çmimi i energjisë elektrike do të jetë 9.5 lekë/kWh për të gjithë sasinë e konsumuar gjatë një muaji</i>		
<i>**Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është:</i>		
<i>Për periudhën 1 Nëntor -31 Mars nga ora 18:00 - 22:00</i>		
<i>Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 - 23:00</i>		



VENDIM
Nr. 11, datë 8.1.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN DHJETOR 2024, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.1.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 26 prot., datë 6.1.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- “FSHU” sh.a. me shkresën nr. 7780 prot., datë 31.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2655 prot., datë 31.12.2024, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin dhjetor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin dhjetor 2024 shoqëria “FSHU” sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- Për përlogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), “FSHU” sh.a. është bazuar në blerjet ditore/mujore të saj në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për muajin dhjetor 2024, profilet ditore të prokuruar në Bursë, çmimin ditor/orar, si dhe vlerën e faturës ditore.

- Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike

(ÇBEt), i përlogaritur nga shoqëria për muajin dhjetor 2024 është 14.86 lekë/kwh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rillogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 14.86 lekë/kwh, ashtu siç është pasqyruar edhe në përlogaritjet e përcjella nga vetë shoqëria.

- Referuar aplikimit të shoqërisë “FSHU” sh.a., rezulton se në çmimin e përlogaritur “FSHU” sh.a. shton edhe kostot e disbalancave të përlogaritura për muajin dhjetor 2024.

- Mbështetur në nenin 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2024, janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike e cila për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, e cila mbështetur në vendimin të Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, vijon të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Kostot administrative, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”, vijnë të jenë 1.06 lekë/kwh.

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive të harkut kohor 27.11.2024–30.12.2024.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin dhjetor 2024, përlogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin dhjetor 2024			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	14.86
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.45
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	18.77



- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 18.77 lekë/kwh për muajin dhjetor 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2024, prej 18.77 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrith Ahmeti

VENDIM

Nr. 1, datë 16.1.2025

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", Komisioni i

Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhrin nr. 234, datë 25.10.2024, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 1, datë 16.1.2025 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Elbasan, Dosje përpunimi nr. 1501, në ngarkim të S. A., me dy volume në total me 319 (treqind e nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1968–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, Dosje përpunimi nr. 3488, në ngarkim të P. B., me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, Dosje formularë nr. 2873, në ngarkim të S. N., me 212 (dyqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Huajt, Dosje formularë nr. 2677, në ngarkim të L. M., me 87 (tetëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1949–1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër sekret".

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Fashikull nr. 3282, në ngarkim të V. Q., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1989. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 11, "Sillogu Vorio-Epiriot Follorinë", me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1968–1989. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nën objekti "Sillogu Vorio-Epiriot i Kosturit", me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1985. Niveli i klasifikimit është "Tepër sekret".



8. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 12 “Sillogu Vorio-Epiriot Selanik”, me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1990. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

9. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 8 “Sillogu Vorio-Epiriot Korfuz”, me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1966–1989. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

10. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 14 “Shoqata të ndryshme krahinore të lidhura me Organizatën e Vorio-Epirit”, me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1966–1989. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

11. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 7 “Sillogu Vorio-Epiriot Athinë-Pire”, me 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1990. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

12. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje nr. 9 “Sillogu Vorio-Epiriot në Janinë”, me 153 (njëqind e pesëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1965–1990. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

13. Arkiva e Autoritetit, Fondi Drejtoria II, Dosje “Sillogu Vorio-Epiriot në Francë-Egipt-Argjentinë-Australi”, me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1985. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.

14. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Kukës, Dosje përpunimi nr. 2366, në ngarkim të R. E., dhe fashikull personal për të dënuar, në total me 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1967–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

15. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnje, Dosje përpunimi nr. 463, në ngarkim të I. S., me 215 (dyqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1959–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

16. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Dosje formulare nr. 3398, në ngarkim të S. J., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

17. Arkiva e Autoritetit, Fondi i Veçantë, Dosje personale dhe pune nr. 6276, “Sportisti” në ngarkim të P. P., në total me 132 (njëqind e tridhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

18. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Fashikull nr. 2680/67, në ngarkim të P. P., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

19. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisur, Fashikull nr. 2365, në ngarkim të T. H., me 104 (njëqind e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1944–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

20. Arkiva e Autoritetit, Fondi Kosova, Dosje fashikullore nr. 6765, në ngarkim të M. M., me 25 (njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1948–1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gentiana Sula

VENDIM Nr. 2, datë 16.1.2025

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në



vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 234, datë 25.10.2024, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 ‘Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH’”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 2, datë 16.1.2025, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje Personale nr. 131(9638), me pseudonimin “Stampa”, me 512 (pesëqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1990. Niveli i klasifikimit i dosjes është “Tepër sekret”.

2. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje personale dhe pune nr. 6127, me pseudonimin “Tigri”, me 49 (dyzet e nëntë) dhe 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1959–1989. Niveli i klasifikimit i dosjes është “Tepër sekret”.

3. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje personale nr. 12189, me pseudonimin “Gazetari”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1989. Niveli i klasifikimit i dosjes është “Tepër sekret”.

4. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje personale nr. 13513, me pseudonimin “Morava”, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1980. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

5. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje personale dhe pune nr. 8476, me pseudonimin “Stilografi”, me 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) dhe 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1966–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”.

6. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Libër i Evidencës operative nr. 87, me 225

(dyqind e njëzet e pesë) fletë. Dokumenti daton në vitet 1970–1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

7. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Libër i Evidencës agenturale – operative nr. 1439, me 283 (dyqind e tetëdhjetë e tre) fletë. Dokumenti daton në vitet 1971–1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

8. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Libër i Evidencës agenturale – operative nr. 2919, me 280 (dyqind e tetëdhjetë) fletë. Dokumenti daton në vitet 1971–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

9. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Libër i Evidencës operative nr. 21, me 220 (dyqind e njëzet) fletë. Dokumenti daton në vitet 1971–1988. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

10. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Libër i Evidencës operative (pa numër), me 225 (dyqind e njëzet e pesë) fletë. Dokumenti daton në vitet 1972–1991. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

11. Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Libër i Evidencës agenturale – operative nr. 2819, me 272 (dyqind e shtatëdhjetë e dy) fletë. Dokumenti daton në vitet 1970–1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gentiana Sula

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 112 lekë